

GJYKATA E QARKUT NË PRIZREN
P. Nr. 288/11
Aktgjykimi NI

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Qarkut në Prizren me Trupin Gjykses të përbërë nga:

Cornelie Peeck (EULEX) Kryetar i Trupit Gjykses
Naim Kurteshi, anëtar i Trupit Gjykses
Rasim Behluli, anëtar i Trupit Gjykses

Me proces-mbajtësin Christine Sengl

Në lëndën penale kundër:

NI, SB, NA, HB, AB, BI, TB, HT dhe HBI,

Të gjithë të pandehurit të akuzuar me veprat penale si në vijim:

I

- 1) Krim i organizuar, në kundërshtim me nenin 274, paragrafi 2, Kodi Penal i Kosovës (KPK)
- 2) Kontrabandim me migrantë, në kundërshtim me nenin 138, paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1, KPK;

Të pandehurit NI dhe HB të akuzuar me veprën penale:

II

Pronësi, kontroll, posedim apo përdorim të paautorizuar të armëve, në kundërshtim me nenin 328, paragrafi 2, KPK;

I pandehuri NI i akuzuar me veprën penale:

III

Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e narkotikëve dhe substancave të rrezikshme psikotropike, në kundërshtim me nenin 229, paragrafi 1, KPK;

Pas seancave të hapura për publikun të mbajtura më 17, 18, 19 dhe 20 prill, 4, 7 dhe 11 qershor, 9, 10 dhe 11 korrik, 1 dhe 2 gusht dhe 17 shtator 2012, në prani të Prokurorit Special Z. Besim Kelmendi, të akuzuarit e përmendur më lart dhe avokatët mbrojtës Fazli Balaj për NI, Muharrem Hoti për SB, Haser Susuri për NA, Arta Mustafa për HB, Brahim Sopa për AB, Osman Zajmi për BI, Gezim Kollcaku për TB, Naim Qelaj për HT dhe Rasim Krasniqi për HBI;

Pas pleqërimit të Trupit Gjykses më 19 shtator 2012;

Shpallet më 20 shtator 2012 hapur për publikun ky aktgjykim.

DISPOZITIV

NI, emri i babait XX, emri i nënës XX, me vendbanim në fshatin X (X), i lindur më XX 1966 në fshatin X (X), bujk, me kushte të dobëta ekonomike, shqiptar i Kosovës, shkolla e mesme, i martuar, dy fëmijë, në paraburgim nga 18 maj 2011 deri më 21 prill 2012,

1. Shpallet **FAJTOR** për veprën e përshkruar nën pikën I (2) të aktakuzës sepse rezultatet e regjistrimit të numrave të telefonit të tij, përgjimit të telefonit të tij dhe deklaratat e dëshmitarëve dëshmojnë se ai nga një kohë e pacaktuar e deri më 18 maj 2011 ka pasur kontakte të shpeshta me bashkë-kryerës brenda dhe jashtë Kosovës, dhe me këta ka diskutuar vendndodhjet, pagesat dhe numrin e migrantëve me telefon. Me dëshmitarët ai diskutoi detalet e udhëtimeve që kishin të bënë me këta dëshmitarë apo të afërmit e tyre. Me këto veprime, ai ka kryer veprën penale të kontrabandimit me migrantë në kundërshtim me nenin 138, paragrafi 2, KPK;
2. Shpallet **FAJTOR** për veprën e përshkruar nën pikën II të aktakuzës sepse më 18 maj 2012 janë gjetur dy armë në posedim të tij dhe për këto ai ka deklaruar se nuk ka leje për armëmbajtje. Këto armë, sipas deklaratës së të pandehurit, kanë qenë në posedim të tij që nga lufta. Nëpërmjet kësaj, ai ka kryer veprën penale të pronësisë së paautorizuar të armës, në kundërshtim me nenin 154, paragrafi 6, KPK;
3. **LIROHET** për veprën e përshkruar nën pikën I (1) të aktakuzës, kinse ai nga një kohë e pacaktuar e deri më 18 maj 2011 ishte anëtar i një grupi të organizuar kriminal të përfshirë në kontrabandim me migrantë;
4. **LIROHET** për veprën e përshkruar nën pikën III të aktakuzës, kinse ai nga një kohë e pacaktuar e deri më 18 maj 2011 me qëllim të shitjes, ishte në posedim të sasisë prej 2,02 gram kanabis, substance narkotike;

SB, emri i babait X, emri i nënës X, me vendbanim në fshatin X (X), i lindur më XX 1969 në fshatin X (X), ka të kryer shkollën e mesme, auto-mekanik, me gjendje mesatare financiare, shqiptar i Kosovës, i martuar, me katër fëmijë,

1. **LIROHET** për veprat e përshkuara nën pikën I (1 dhe 2) të aktakuzës se ai nga një kohë e pacaktuar e deri më 18 maj, si anëtar i një grupi të organizuar, ishte i përfshirë në kontrabandim të migrantëve;

NA, emri i babait X, emri i nënës X, me vendbanim në fshatin X (X), i lindur më XX 1974 në fshatin X (X), ka të kryer shkollën fillore, shofer, në gjendje të varfër ekonomike, shqiptar i Kosovës, i martuar, me një fëmijë, në paraburgim nga 18 maj 2011 deri më 30 qershor 2011;

1. Shpallet **FAJTOR** për veprën e përshkruar nën pikën I (2) të aktakuzës sepse rezultatet e regjistrimit të numrit të tij të telefonit dhe atë të të tjerëve, përgjimit të telefonit të tij dhe të të tjerëve dhe deklaratat e dëshmitarëve vërtetojnë se nga një kohë e pacaktuar e deri më 18 maj 2011 ka pasur kontakte të shpeshta me telefon me NI, me të cilin diskutoi vendndodhjet, pagesat dhe numrin e migrantëve, duke kryer në këtë mënyrë veprën penale kontrabandim me migrantë në kundërshtim me nenin 138, paragrafi 2, KPK;

2. **LIROHET** nga vepra e përshkruar nën pikën I (1) të aktakuzës se ai nga një kohë e pacaktuar e deri më 18 maj 2011 ishte anëtar i një grupi të organizuar kriminal të përfshirë në kontrabandim të migrantëve,

HB, emri i babait X, emri i nënës X, me vendbanim në fshatin X (X), i lindur XX 1952 në fshatin X (X), ka të kryer shkollën e mesme, auto- mekanik dhe bujk, në gjendje të varfër financiare, shqiptar i Kosovës, i martuar, me katër fëmijë, në paraburgim nga 18 maj 2011 deri më 30 qershor 2011,

1. Shpallet **FAJTOR** për veprën e përshkruar nën pikën I (2) të aktakuzës sepse rezultatet e regjistrimit të telefonit të tij dhe të tjerëve, përgjimin e telefonave të tij dhe të tjerëve, dhe deklaratat e dëshmitarëve dëshmojnë se nga koha e pacaktuar e deri më 18 maj 2011 kishte pasur kontakte të shpeshta me telefon me NI, me të cilin kishte diskutuar vendndodhjet, pagesat dhe numrin e migrantëve. Ai poashtu kishte diskutuar me migrantë potencialë mundësitë të udhëtimit jashtë vendit. Nëpërmjet këtyre veprimeve ai ka kryer veprën penale të kontrabandimit me migrantë në kundërshtim me nenin 138, paragrafi 2, KPK;
2. **LIROHET** nga vepra e përshkruar në pikën I (1) të aktakuzës se nga një kohë e pacaktuar e deri më 18 maj 2011 ishte anëtar i një grupi të organizuar kriminal të përfshirë në kontrabandim me migrantë;
3. **LIROHET** nga vepra e përshkruar nën pikën II të aktakuzës se kishte pasur në posedim nga një kohë e pacaktuar deri më 18 maj 2011 pushkë gjuetie, për të cilën nuk kishte leje të vlefshme për armëmbajtje;

AB, emri i babait X, emri i nënës XX, me vendbanim në fshatin X (X), i lindur më XX 1979 në fshatin X (X), ka të kryer shkollën e mesme, punëtor fasade, në gjendje të varfër financiare, shqiptar i Kosovës, beqar,

1. Shpallet **FAJTOR** për veprën e përshkruar nën pikën I (2) të aktakuzës sepse përgjimi i telefonit të tij dhe deklaratat e dëshmitarëve dëshmojnë se ai ka sjellë njerëz te shoferi i taksisë për transport të mëtejshëm dhe se ka qenë i përfshirë në bërje të rremë të vizës dhe ka diskutuar mundësitë e udhëtimit jashtë vendit. Nëpërmjet këtyre veprimeve ai ka kryer veprën penale të kontrabandimit me migrantë në kundërshtim me nenin 138, paragrafi 2, KPK;
2. **LIROHET** nga vepra e përshkruar nën pikën I (1) të aktakuzës se nga një kohë e pacaktuar e deri më 18 maj 2011 ishte anëtar i një grupi të organizuar kriminal të përfshirë në kontrabandim me migrantë;

BI, emri i babait X, emri i nënës X, me vendbanim në fshatin X (X), i lindur më XX 1983 në fshatin X (X), ka të kryer shkollën filllore, roje sigurimi në Kuvendin Komunal, në gjendje të varfër financiare, shqiptar i Kosovës, i martuar, 18 maj 2011 deri më 30 qershor 2011,

Shpallet **FAJTOR** për veprën e përshkruar nën pikën I (2) të aktakuzës sepse rezultatet e regjistrimit të telefonave të tij dhe të tjerëve, përgjimet e telefonit të tij dhe deklaratat e dëshmitarëve dhe zbulimi i të dhënave financiare dëshmojnë se nga një datë e pacaktuar e deri më 18 maj 2011 kishte kontakte të shpeshta me telefon me NI, me të cilin kishte diskutuar vendndodhjet, pagesat dhe numrin e migrantëve dhe se në llogarinë e tij bankare janë pranuar dhe janë bërë pagesa nga jashtë. Nëpërmjet këtyre veprimeve ai ka kryer veprën penale kontrabandim me migrantë në kundërshtim me nenin 138 paragrafi 2, KPK;

1. **LIROHET** nga vepra e përshkruar nën pikën I (1) të aktakuzës se nga një datë e pacaktuar e deri më 18 maj 2011 ishte anëtar i një grupi të organizuar kriminal i përfshirë në kontrabandim të migrantëve;

TB, emri i babait X, emri i nënës X, me vendbanim në fshatin X (X), i lindur më XX 1972 në X, ka të kryer shkollën e mesme, pronar i një kompanie private për dhënie me qera të veturave dhe një kazino, në gjendje të mirë financiare, shqiptar i Kosovës, i martuar, me katër fëmijë,

1. Shpallet **FAJTOR** për veprën e përshkruar nën pikën I (2) të aktakuzës sepse rezultatet e regjistrimit të numrave të telefonit, përgjimit të telefonave të tjerë dhe deklaratat e dëshmitarëve dëshmojnë se nga një datë e pacaktuar e deri më 18 maj 2011 kishte kontakte të shpeshta me bashkë-kryerës brenda dhe jashtë Kosovës dhe me ta kishte diskutuar vendndodhjet e migrantëve dhe numrin e migrantëve nëpërmjet telefonit. Ai ruajti të hollat për migrantët. Nëpërmjet këtyre veprimeve, ai ka kryer veprën penale të kontrabandimit të migrantëve, në kundërshtim me nenin 138, paragrafi 2, KPK;
2. **LIROHET** nga vepra e përshkruar nën pikën I (1) të aktakuzës se nga një datë e pacaktuar e deri më 18 maj 2011 ishte anëtar i një grupi të organizuar kriminal të përfshirë në kontrabandim me migrantë;

HT, emri i babait X, emri i nënës X, me vendbanim në X (X), i lindur më XX 1976 në X (X), ka të kryer shkollën fillore, tregtar bagëtitish, në gjendje të mesme financiare, shqiptar i Kosovës, i martuar, me tre fëmijë, 18 maj 2012 deri më 30 qershor 2011,

1. **LIROHET** nga veprat e përshkruara nën pikët I (1 dhe 2) të aktakuzës se nga një datë e pacaktuar e deri më 18 maj si anëtar i një grupi të organizuar ishte i përfshirë në kontrabandim me migrantë;

HBI, emri i babait X, emri i nënës X, me vendbanim në fshatin X (X), i lindur më XX 1984 në fshatin X (X), ka të kryer Shkollën Teknike të Bujqësisë (shkolla e mesme), bujk, në gjendje të varfër financiare, shqiptar i Kosovës, i martuar, me dy fëmijë, 18 maj 2011 deri më 30 qershor 2011,

1. **LIROHET** nga veprat e përshkruara në pikët I (1 dhe 2) të aktakuzës se nga një datë e pacaktuar e deri më 18 maj si anëtar i një grupi të organizuar ishte i përfshirë në kontrabandim me migrantë;

Për arsyet e përmendura më lart, Trupi Gjykesor sjellë si në vijim

DËNIME

1. NI

Në pajtim me nenin 138, paragrafi 6 dhe neni 23, KPK, dënohet me burgim prej 3 (tre) vjetë dhe 5 (pesë) muaj;

Në pajtim me nenin 328, paragrafi 2, KPK, dënohet me gjobë prej € 1500 (një mijë e pesëqind euro);

Në pajtim me nenin 328, paragrafi 5, KPK lidhur me nenin 60, KPK, konfiskohen arma Cervena Zastava (revolver), numri serik C-132079, me karikatorin që përmban 9 (nëntë) plumba dhe armën Ekol Tuna (revolver), numri serik ET-892018 dhe 4 (katër) plumba, kalibri 7,62 mm, M 57 me karikator nëntësh me 8 plumba 7,62 mm;

Në pajtim me nenin 229, paragrafi 5 lidhur me nenin 60, KPK, konfiskohet sasia prej 2.02 gram të substancës narkotike kanabis.

Në pajtim me nenin 73, KPK, koha e kaluar në paraburgim (nga 18 maj 2011 – 21 prill 2012 = 339 ditë) dhe nën arrest shtëpiak (nga 21 prill 2012 deri më 20 shtator 2012 = 152 ditë) përfshihet në dënim.

2. NA

Në pajtim me nenin 138, paragrafi 6 dhe neni 23, KPK, dënohet me burgim prej 1 (një) viti;

Në pajtim me nenin 73, KPK, koha e kaluar në paraburgim (nga 18 maj 2011 – 30 qershor 2012 = 43 ditë) llogaritet në dënim.

3. HB

Në pajtim me nenin 138, paragrafi 6 dhe neni 23, KPK, dënohet me burgim prej 1 (një) viti;

Në pajtim me nenin 73, KPK, koha e kaluar në paraburgim (nga 18 maj 2011 – 30 qershor 2012 = 43 ditë) llogaritet në dënim.

4. AB

Në pajtim me nenin 138, paragrafi 6 dhe neni 23, KPK, dënohet me burgim prej 1 viti;

5. BI

Në pajtim me nenin 138, paragrafi 6 dhe neni 23, KPK, dënohet me burgim prej 1 viti;

Në pajtim me nenin 73, KPK, koha e kaluar në KPK, koha e kaluar në paraburgim (nga 18 maj 2011 – 30 qershor 2012 = 43 ditë) do të përfshihet në dënim.

6. TB

Në pajtim me nenin 138, paragrafi 6 dhe neni 23, KPK, dënohet me burgim prej 2 (dy) vjetë dhe 5 (pesë) muaj;

SHPENZIMET

Në pajtim me nenin 102, paragrafi 1, Kodi i Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), personat e dënuar paguajnë shpenzimet e procedurës. Respektohet dispozitat e nenit 100, paragrafi 2, KPPK dhe do të nxirret një vendim i veçantë mbi shumën e shpenzimeve.

Shpenzimet për të pandehurit SB, HaT dhe HBI paguhen nga buxheti i Kosovës.

ARSYETIMI

Historia procedurale

Më 30 shtator 2010, Prokurori Special i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK) lëshoi një vendim për fillimin e hetimeve kundër NI për veprat penale të krimit të organizuar dhe kontrabandë të imigrantëve.

Më 27 mars 2011 Prokuroria Speciale lëshoi një vendim për zgjerimin e hetimeve ndaj SB.

Më 27 janar 2011 Prokuroria Speciale lëshoi një vendim për zgjerimin e hetimeve ndaj SB.

Me vendimin e Gjyqtarit të Procedurës Paraprake të datës 25 mars 2011, u vazhdua hetimi ndaj NI, SB, AB dhe të tjerëve deri më 25 shtator 2011.

Më 19 prill 2011 Prokuroria Speciale lëshoi një vendim për zgjerimin e hetimeve ndaj HT dhe HB.

Më 13 maj 2011 Prokuroria Speciale lëshoi një vendim për zgjerimin e hetimeve ndaj NA, BI dhe HBI.

Më 19 maj 2011, Gjyqtari i Procedurës Paraprake ka urdhëruar paraburgimin ndaj NI, HT, HB, NA, BI-t dhe HBI.

Më 16 qershor 2011 paraburgimi kundër këtyre të pandehurve u vazhdua. Më 30 qershor 2011 Gjykata Supreme ka konfirmuar vazhdimin e paraburgimit ndaj NI ndërsa kundër të dyshuarve të tjerë paraburgimi është ndërprerë.

Më 24 nëntor 2011 Gjyqtari për Konfirmim konfirmoi aktakuzën PPS nr. 94/10 të datës 18 tetor 2011, e ngritur më 2 nëntor 2011.

Gjykimi kryesor filloi më 17 prill 2012. Dëshmitarët u dëgjuan më 18 prill, 19 prill, 20 prill, 7, 9 qershor dhe 10 korrik 2012. Të pandehurit u dëgjuan më 11 korrik, 1 dhe 2 gusht 2012. Më 17 shtator 2012 u parashtruan fjalët përmbyllëse.

Nga ana e trupit gjykues më 21 prill 2012 paraburgimi kundër NI u zëvendësua me arrest shtëpiak. Masa e arrestit shtëpiak është ndërprerë më 20 shtator 2012.

Provat e paraqitura

Gjatë shqyrtimit gjyqësor janë administruar provat të listuara në Shtojcën I.

Gjatë shqyrtimit kryesor janë dëgjuar dëshmitarët të cekur më poshtë.

XT më 18 prill 2012

QK më 18 prill 2012

AP më 19 prill 2012

IB nga 19 prill 2012

TA më 19 prill 2012

EA më 20 prill 2012

AD më 20 prill 2012

NS më 20 prill 2012

BH më 7 qershor, 2012

SB në 7 qershor 2012

SP më 7 qershor, 2012

FT në 7 qershor 2012

RB më 9 korrik 2012

DG më 9 korrik 2012

BV më 9 korrik

BM më 10 korrik 2012

DRG në korrik 10, 2012

AH më 10 korrik 2012

Me pëlqimin e prokurorit publik, Avokatëve Mbrojtës dhe të pandehurve, deklaratat e dëshmitarëve në vijim janë konsideruar të lexuara, meqë vendbanimi i këtyre dëshmitarëve nuk ka patur mundësi të sigurohet në kohë dhe se hetimet e mëtejshme do të shkaktonin vonesa të panevojshme në procedurë:

KM më 9 korrik 2012

RK më 9 korrik 2012

MN më 11 korrik 2012

AR më 9 korrik 2012

Vlerësimi i provave

Pranueshmëria 1.0

Prokurori në argumentet gjatë fjalës së tij përmbyllëse i është referuar bisedave telefonike të nxjerra më

27 janar 2011, nga përgjimet e telefonit numër: 04XX. Këto përgjime nuk janë të përfshira në dosjen e lëndës dhe prandaj nuk mund të përdoren si dëshmi. Edhe në qoftë se ata ishin të përfshirë në dosjen e lëndës, këto biseda janë provë e papranueshme, sepse ata rrjedhin nga përgjimet bazuar në një urdhër të përkohshëm nga prokurori e cila nuk është konfirmuar nga gjyqtari i procedurës paraprake brenda 24 orëve nga lëshimi i saj në pajtim me nenin 258, paragrafi 4 i KPPK.

Gjykata konsideron të gjitha deklaratat e bëra nga dëshmitarët të pranueshme, sepse avokatëve mbrojtës ose iu dha mundësia për të sfiduar këto deklaratat gjatë shqyrtimit kryesor, ose të hiqnin dorë nga kjo e drejtë duke lejuar leximin e deklaratave gjatë shqyrtimit kryesor të dhëna para policisë ose prokurorit .

NB nuk është thirrur, sepse deklarata e tij dhënë në polici ishte i bazuar në thashetheme dhe duke pasur parasysh dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë nuk është e nevojshme. Deklaratat e dhëna nga dëshmitarët kjo nuk do të përdoren si dëshmi.

Gjykata vendosi të mos thërrasë VB dhe EB, sepse ata janë jashtë dhe adresat e tyre janë të panjohura. XK është thirrur, por sipas dëshmisë së dorëzimit ai është edhe jashtë vendit, pa ndonjë adresë të njohur. Hetimet e mëtejshme për adresat do të shkaktojë vonesa të panevojshme në procedurë.

Transkriptimet e përgjimeve, të marra nga autoritetet e policisë shqiptare janë të pranueshme. Ndihma juridike ndërkombëtare është e bazuar në parimin se procedimet penale në shtetet e përfshira janë kryer në përputhje me ligjin. Shteti kërkues nuk është i detyruar në bazë të këtij parimi për të siguruar se procedurat e duhura penale janë kryer si duhet në shtetin tjetër, përveç nëse ka indikacione se ka një shkelje të procedurës penale.

Në këtë rast nuk ka indikacione se procedurat në Shqipëri nuk janë kryer në përputhje me ligjin penal shqiptar. Prandaj transkriptet e përgjimeve të marra nga autoritetet shqiptare janë dëshmi të pranueshme në këtë procedurë.

Asnjë kërkesë nuk është bërë në lidhje me pranueshmërinë e provave të tjera.

1.1 Deklaratat e dëshmitarëve

1.1.1 XT

Dëshmitari ishte intervistuar nga policia më 11 maj 2011. Ai ka deklaruar se ai u arrestua në Hungari, pas kalimit të paligjshëm të kufirit me Serbinë. FT i kishte gjetur atij një person, i cili i mundësoi dëshmitarit që të largohet nga Kosova, të quajtur N nga X. Dëshmitari ka marrë një numër të telefonit të Valës përmes së cilët ai e kontaktoi N. Ai bëri një marrëveshje me N, se ai do ta marrë atë për 2600 €. Paratë do të ishin lënë me të vëllain e tij RT, derisa dëshmitari do të kishte arritur në Itali. Sipas dëshmitarit ai u soll nga X në Gjilan, ku ai kishte takuar N. Së bashku me katër të tjerët ai hyri në një automjet i cili i solli ata në afërsi të kufirit me Serbinë. Së bashku me 10 të tjerë, ai kaloi kufirin në këmbë për të arritur në

Tërnoc në Serbi. Nga atje një taksi i mori ata në Suboticë. Gjatë udhëtimit në Suboticë dëshmitari është kontaktuar nga N. Në Suboticë ata janë marrë me taksi në kufirin Hungarezo-Serbë. Ata kaluan kufirin në këmbë dhe u kapën në Hungari. Pas kthimit në Kosovë, dëshmitari u takua me N i cili i dha atij 400 € për biletë avioni.

Dëshmitari dha në polici, si numrin e tij të telefonit 04XX/04XX

Më 18 prill 2012 dëshmitari dëshmoi në gjykatë. Ai deklaroi se FT i dha numrin e telefonit të një personi i cili do ta dërgonte atë jashtë në Hungari. Dëshmitari e kontaktoi këtë person dhe i ka marrë udhëzimet. Rreth deklaratës së tij të mëparshme ai ka deklaruar se kjo nuk është e vërtetë, edhe pse ai e ka nënshkruar atë. Dëshmitari kishte qenë në konsum të alkoolit dhe personat që e intervistuan atë nuk ishin në uniformë. Dëshmitari pyeti për shpenzimet e biletave të avionit të tij. Ai nuk ka paguar asnjë para, sepse ai vetëm kishte për të paguar për udhëtimin e sigurve pasi ai të arrinte në Itali.

Më 8 prill 2011 një thirrje telefonike në mes të dëshmitarit XT (04XX) dhe NI (04XX) u kap. Dëshmitari prezantoi veten si fqinji i F i cili u largua për në Itali me anë të tij (N). N përgjigjet duke thënë se ai do të thërrasë X përsëri me një numër telefoni tjetër.

Gjykata konstaton se ky dëshmitar është i besueshëm. Deklarata e tij se ai ishte kontrabanduar jashtë vendit nëpërmjet NI është mbështetur nga rezultatet e matjes së thirrjeve telefonike dhe përgjimeve. Edhe pse dëshmitari deklaroi se deklarata e tij e dhënë për policinë ishte e pavërtetë, gjykata do ta përdor këtë deklaratë gjithashtu si dëshmi, për shkak se përmbajtja e kësaj deklarate është mbështetur nga dëshmi të tjera.

1.1.2 QK

Dëshmitari ka bërë deklaratë në polici më 23 maj 2011 si dhe dëshmoi në gjykatë më 18 prill 2012.

Gjykata nuk do ta konsiderojë deklaratën e tij, sepse ajo nuk përmban informacion specifik në lidhje me njërin nga të pandehurit.

1.1.3 AP

Ky dëshmitar deklaroi në Polici më 25 maj 2011 se djali i tij O shkoi jashtë shtetit nga fundi i marsit 2011. Djali i tij i dha atij numrin e telefonit të njëfarë N nga X, i cili e kishte dërguar djalin e tij jashtë vendit. Numri i telefonit i N ishte 04XX.

Dëshmitari i dha policisë, si numrin e tij të telefonit 04XX.

Dëshmitari dëshmoi në gjykatë më 19 prill 2012. Ai konfirmoi se djali i tij shkoi jashtë vendit. Djali i tij i kërkoi atij para. Ai ka menduar se djali i tij ishte duke shkuar jashtë vendit ligjërisht me vizë. Ai kontaktoi numrin e telefonit që ia kishte lënë djali i tij në një apo dy raste. Dëshmitari njohu nënshkrimin poshtë

deklaratës së mëparshme si të tijin.

Nga rezultatet e regjistrimit të numrave të telefonit rrjedh se ky dëshmitar kishte kontaktuar NI më 9 janar 2011 në numrin e tij: 04XX. Pas kësaj bisede, ka pasur kontakte mes numrave të telefonave 04XX dhe 04XX dhe numri i telefonit të dëshmitarit mes 9 janar 2011 dhe 14 janar 2011.

Deklarata e dëshmitarit është mbështetur nga rezultatet e regjistrimit të numrave të telefonit. Gjykata konstaton se ky dëshmitar është i besueshëm, dhe deklarata e tij do të përdoret si dëshmi.

1.1.4 TA

Kur u intervistua nga policia më 3 qershor 2011 ky dëshmitar ka deklaruar se djali i tij E u përpoq për të shkuar jashtë vendit nëpërmjet N nga X. N kishte kërkuar që ti paguheshin atij 1400 €, 200 € për taksi dhe 200 € para të udhëtimit që do të merreshin nga djali i tij. E iu bashkëngjiti në Deçan. Ai kaloi kufirin afër Gjilanit për në Preshevë dhe deri në Suboticë. 1000 € do të duheshin që ti paguheshin N pasi që E të kishte mbërritur në Austri. Ndërsa TB nga Raushiqi do të garantonte për këto para.

Gjatë intervistës dëshmitarit iu kontrollua telefoni për numrin e telefonit të N, ku është gjetur numri 04XX nën emrin e TB.

Dëshmitari i dha policisë, si numrin e telefonit 04XX si të tijin.

Dëshmitari dëshmoi në gjykatë më 19 prill 2012. Ai ka deklaruar se djali i tij E kishte udhëtuar jashtë vendit. Ai shkoi me një familje. Ata janë marrë nga një njeri i quajtur N ose NZ. Ky emër i është dhënë dëshmitarit nga policia. Dëshmitari e ka kontaktuar këtë person para se të largohej djali i tij. Sipas dëshmitarit ai i mbajti paratë vetë. Nuk kishte të përfshirë asnjë garantues. Pasi u ballafaquar me deklaratën e tij të mëparshme, dëshmitari pranoi se në deklaratë ishte nënshkrimi i tij. Ai e mohoi që kishte thënë se T ishte përfshirë si garantues i parave. Dëshmitari tha se ai i kishte huazuar paratë nga T, të cilin ai e kishte të afërt. Ndërsa Policia në vend të kësaj e kishte shkruajtur se T ishte garantuesi. Dëshmitari ka deklaruar se ai nuk e kishte lexuar deklaratën e tij para se ata nënshkroi atë dhe as që e njëjta i ishte lexuar atij.

Më 24 mars 2011 u përgjua një bisedë në mes të numrit të telefonit 04XX dhe numrit të telefonit të përdorura nga TA 04XX. Pas këtij kontakti janë regjistruar kontaktet në mes të këtij numri të telefonit dhe numrit 04XX, i cili u gjet në telefonin e dëshmitarit me emrin TB.

Deklarata e këtij dëshmitari është mbështetur me dëshmi teknike. Gjykata konstaton se deklarata e parë e dhënë në polici është më e besueshme se sa dëshmia e dhënë në gjykatë. Dëshmitari nuk ka dhënë ndonjë shpjegim se pse policia do të kishte shkruar informatën e cila nuk është dhënë nga dëshmitari.

1.4.5 EA

Gjatë marrjes në pyetje të tij nga ana e policisë ai pranoi se në mars të vitit 2011 ai kishte udhëtuar

jashtë vendit ilegalisht përmes Suboticës për në Hungari. Ai u arrestua dhe mbajt në arrest në Hungari. Ai u kthye në Kosovë më 1 qershor 2011. Aranzhimet për këtë udhëtim janë bërë nga i ati i tij TA cili kishte kontaktuar një person me emrin N nga X. N i është paguar shuma e 1400 €-ve. Dëshmitari kishte biseduar me N në telefon disa ditë para se ai të udhëtonte me ç' rast N ia kishte shpjeguar detajet e udhëtimit të tij. Numri i përdorur nga ana e dëshmitarit ishte 04XX ose 04XX.

Dëshmitari dëshmoi në gjykatë më 20 prill 2012. Ai deklaroi se në ditën që ai u largua, udhëtoi me makinë për në Gjilan. Atje u takua me familjen me të cilën do të udhëtonte. Ata kaluan kufirin në këmbë dhe u morën me makinë për në Suboticë. Këtu ai u vendos për disa ditë dhe e sollën në një vend në afërsi të kufirit me Hungarinë. Ata e kaluan kufirin më natë në këmbë dhe u arrestuan në Hungari. Dëshmitari deklaroi se deklarata e tij e mëparshme nuk i ishte lexuar atij para se ai ta nënshkruante atë. Kur u ballafaqua me deklaratën e tij se ai kishte folur një herë në telefon me N, dëshmitari tha se policia këmbëngulte për këtë emër.

Deklarata e këtij dëshmitari mbështetet nga provat teknike të përmendura më lart. Dëshmitari nuk ka dhënë ndonjë arsye se përse policia do të këmbëngulte për emrin N kur u intervistua herën e parë. Gjykata gjen si gati të pamundur që policia të ja ketë dhënë dëshmitarit këtë emër. Gjykata e konstaton deklaratën e dhënë në polici të besueshme.

1.1.6 AD

Dëshmitari dha një deklaratë në polici më 12 korrik 2011, si dhe dëshmoi në gjykatë më 20 prill 2012.

Gjykata nuk do ta konsiderojë deklaratën e tij për shkak se kjo deklaratë nuk është e mbështetur nga dëshmi të tjera. Prandaj, gjykata nuk mund të vendosë se personi përmes së cilit ky dëshmitar ka shkuar jashtë vendit është i pandehuri NI. Dëshmitari kurrë nuk e ka parë të pandehurin dhe se me të ka folur në telefon vetëm dy herë para 19 shtatorit të vitit 2010. Nuk ka rezultate të regjistrimit të cilat tregojnë ndonjë kontakt mes telefonit të pandehurit dhe telefonit të këtij dëshmitari.

1.1.7 NS

Dëshmitari ishte intervistuar nga policia më 12 korrik 2011. Ai ka deklaruar se vëllai i tij B jeton jashtë vendit. Ai ka shkuar t në Gjermani ilegalisht, nëpërmjet një personi me emrin N nga X. Dëshmitari mendon se vëllai i tij është dashur të paguaj 2000 € për udhëtimin dhe 300 € deri në 400 € për shpenzime të udhëtimit. Vëllai i tij ia ka paguar paratë N para udhëtimit.

Më 20 prill 2012 dëshmitar dëshmoi në gjykatë. Ai ka deklaruar se vëllai i tij B shkoi në Gjermani. Dëshmitari nuk e di se si shkoi ai. Vëllai i tij e ka diskutuar udhëtimin e tij në telefonin e dëshmitarit. Numri i telefonit është 04XX. B ka paguar 2000 € për udhëtimin. Dëshmitari pranoi se është nënshkrimi i tij në deklaratën e tij të dhënë në polici.

Më 22 shkurt 2011 u përgjua një thirrje telefonike në mes të dëshmitarit dhe NI, në të cilën dëshmitari pyeti të pandehurin nëse ai është ende duke punuar. I pandehuri e konfirmon këtë dhe do të thërrasë dëshmitarin më vonë.

Deklarata e dëshmitarit është mbështetur nga dëshmi të tjera. Gjykata konstaton këtë dëshmitar si të besueshëm.

1.1.8 BH

Gjatë marrjes në pyetje nga ana e prokurorit publik, dëshmitari deklaroi se ai e njeh AB. Ai e kishte kontaktuar AB, sepse ai donte të shkonte jashtë shtetit. Dëshmitari deklaroi se AB i kishte thënë atij se ai do t'ia paguante atij € 100 € për person nëse ai do të gjente njerëz të interesuar për të shkuar jashtë shtetit. Dëshmitari pranoi se ai diskutoi me AB më 10, Mars 2011, për shkuarjen e një të afërmi. Sipas dëshmitarit AB i tha atij se ai do të duhej të paguante 2100 € për të shkuar në Austri. I afërmi i tij duhet të paguaj të njëjtin çmim, por pasi që ajo tha se ishte shumë e madhe, AB tha se do të merreshin vesh pas arritjes së saj. AM i kishte thënë dëshmitarit se njerëzit do të kalonin nëpër Serbi. Numri i telefonit të dëshmitarit është 04XX.

Dëshmitari dha dëshminë e tij në gjykatë më 7 qershor 2012. Ai tha se ai e njohte AB nga me parë. Ai e kishte kontaktuar atë, sepse ai kishte dëgjuar nga njerëzit e tjerë që ai mund ta ndihmojë atë për të shkuar jashtë shtetit. Ata pinë nga një kafe dhe diskutuan çmimin, por çmimi ishte shumë i lartë. Një person me emrin AZ i kishte pasur paratë dhe ai shkoi jashtë vendit nëpërmjet AB. AB i kishte thënë dëshmitarit ti tregoi atij nëse ai mund të gjente njerëz që dëshironin të shkojnë jashtë vendit. Kur u ballafaqua ai me deklaratën e tij të mëparshme dëshmitarit nuk iu kujtuar se AB i kishte thënë atij në lidhje me itinerarin e rrugës që e merrnin njerëzit.

Më 22 shkurt 2011 u përgjua një bisedë mes AB dhe BH kap. BH i kishte thënë AB që ai e kishte telefonuar atë nga tjetër telefon, por se ai nuk i është përgjigjur, dhe e informoi atë në lidhje me një familje të vogël. Fëmijët kanë çmimin për gjysmë. Është edhe vajza e një fqinjit. Më 28 shkurt 2011 BH i thotë AB se numri është në rritje në 9 veta. Më 7 mars 2011 AB i thotë BH se ata janë duke pritur për të shtunën. BH i përgjigjet duke i thënë se kushëriri i tij ka nevojë për të shkuar jashtë shtetit. Më 15 mars 2011 AB ankohet se ai nuk mund ta kontaktoj BH në numrin e tij të lpkos dhe e informon atë se "ajo mund të shkojë në anën tjetër të shtunën".

Më 14 mars 2011 BH dhe AB diskutojnë situatën e personave që janë ndaluar në Hungari.

Deklarata e dëshmitarit është mbështetur nga përgjimi i thirrjeve telefonike.

Gjykata konstaton se ky dëshmitar është i besueshëm.

1.1.9 SB

Dëshmitari ka deklaruar në polici më 30 shtator 2011 se ai e njeh një person me emrin N që është nga Peja i cili merret me kontrabandimin e emigrantëve. BSH, djali i xhaxhait të tij bëri marrëveshje me N. N kërkoi 1800-1900 euro dhe 200 euro që ti ketë me vete për shpenzimet e udhëtimit. Dëshmitari e solli BSH tek ura e Gjakovës, ku një person me një golf të kuq e mori atë drejt Prishtinës. Dëshmitari ka garantuar për paratë që babai BSH kishte për të paguar, pasi BSH të kishte arritur në destinacionin e tij. Dëshmitari dha në polici, si numrin e tij të telefonit 04XX.

Dëshmitari dëshmoi përpara gjykatës më 7 qershor 2012. Ai deklaroi se ai kishte kontakte me NI rreth makinave dhe traktorëve. Kushëriri BSH nga ana e babait të tij ishte njëherë i pranishëm kur ai u takua me NI. Ai nuk e di nëse ata folën më pas. Kushëriri i tij u largua nga Kosova dhe kishte për të paguar rreth 1500 €. Kur dëshmitari u konfrontua me deklaratën e tij të mëparshme ai ka thënë se në përgjithësi kjo nuk ishte e saktë. Sipas dëshmitarit ai nuk ka thënë që N i kërkoi € 1800 - 1900, por këto ndoshta ishin shpenzimet. Dëshmitari ka deklaruar se ai nuk e di nëse kushëriri i tij u largua nga Kosova përmes N. Ai pranoi se e kontaktoi N përmes këtij numri. Ai e mohoi të ketë thënë se ai ishte garantuesi për paratë që BSH kishte për të paguar.

Nga matjet e thirrjeve telefonike rezulton se ka pasur kontakte të rregullta mes numrit të telefonit të përdorur nga ana e dëshmitarit dhe numrit të NI midis tetorit 2010 dhe majit 2011. Më 18 shkurt 2011 NI ka kontaktuar dëshmitarin dhe e informoi atë në lidhje me vëllain e tij. Dëshmitari në atë rast i ka thënë NI se është një person tjetër i interesuar për të shkuar në Slloveni, por ai nuk i ka të gjitha paratë. NI i përgjigjet se ai nuk mund të shkojë pa të holla. Më 20 shkurt 2011 NI i thotë dëshmitarit që ti tregoj të birit të ungjit të tij të jetë në urën e Klinës në udhëkryqin e Gjakovës në orën 13. Me 13.09.14 N e kontakton dëshmitarin i cili thotë se ata janë tek udhëkryqi.

Deklarata e parë që dëshmitari e dha në polici mbështetet nga dëshmi të tjera, gjykata e konsideron këtë deklaratë të besueshme, veçanërisht për shkak se dëshmitari pa ndonjë argument të vlefshëm e ndryshoi këtë deklaratë.

1.1.10 SP

Dëshmitari i dha një deklaratë policisë më 19 gusht 2011 dhe ai dëshmoi në gjyq më 7 qershor 2012.

Gjykata nuk do ta konsiderojë deklaratën e tij, sepse ajo nuk përmban informacion specifik në lidhje me njërin nga të pandehurit.

1.1.11 FT

Dëshmitari ishte intervistuar nga prokurori më 19 gusht 2011. Ai deklaroi se X i biri i ungjit të tij u kap në Hungari, gjatë udhëtimit jashtë vendit. Dëshmitari i kishte dhënë X një numër të telefonit të një personi nëpërmjet të cilit vëllai i tij kishte shkuar jashtë vendit. Dëshmitari pranoi se ai kishte biseduar me NI rreth XT, para se ai t'ia jepte X numrin e telefonit. Atij nuk i kujtohet nëse ai ka folur ndonjëherë për HT rreth X ose për persona të tjerë që dëshironin të largoheshin nga Kosova. Dëshmitari dha në polici, si numër të tijin të telefonit 04XX.

Dëshmitari dëshmoi në gjykatë më 7 qershor 2012. Ai mohoi se ai ia kishte dhënë kushëririt të tij X, numrin e një ndërmjetësi për të udhëtuar jashtë vendit. Dëshmitari e njeh NI, sepse ai ia kishte shitur atij një lopë, atij nuk i kujtohet se ai i kishte folur atij për kushëririn e tij. Sipas dëshmitarit vëllai i tij u largua nga Kosova përmes rrugëve ligjore. Dëshmitari mohoi se ai e ka dëgjuar nga X që ai u kap në Hungari. Dëshmitarit nuk i kujtohet që ai ka folur me HT rreth X, por ai e njeh HT si një tregtar viçash.

Janë bërë kontaktet telefonike mes të dëshmitarit dhe të akuzuarit nga 31 tetor 2010 dhe 10 maji 2011 .

Dëshmitari nuk ka ofruar argumente të mjaftueshme se pse deklarata që ishte shkruar nga policia ishte jo korrekte. Deklarata e dëshmitarit e dhënë në polici është mbështetur nga rezultatet e matjes dhe përgjimet. Edhe deklarata e XT mbështet deklaratën e këtij dëshmitari. Gjykata e pranon deklaratën e dhënë në polici si të besueshme.

1.1.12 RB

Kur u intervistuar nga prokurori më 31 gusht 2011, dëshmitari deklaroi se VA djali i tij jeton në Itali. Ai pagoi 2000 € për udhëtimin. Ai udhëtoi nëpër Serbi, Hungari dhe Austri. Nga djalit i tij ai ka marrë një numër të telefonit të cilin ai duhet ta telefonojë në qoftë se ai nuk është dëgjuar me djalin e tij. Me numrin e tij të telefonit dëshmitari e ka kontaktuar këtë numër dhe personi i cili u përgjigj ka pranuar se i ka vënë njerëzit në udhëtime.

Dëshmitari në polici, dha si numër të tij të telefonit 04XX.

Dëshmitari dha dëshminë e tij në gjykatë më 9 korrik 2012. Ai ka deklaruar se djali i tij VA ka dalë jashtë. Djali i tij la një numër për ta thirrur në rast nevojë. Kur dëshmitari telefonoi në këtë numër personi në anën tjetër i tha atij që djali i tij ishte mirë. Numri ishte 04XX.

Gjykata konstaton se deklarata e këtij dëshmitari është e besueshme.

1.1.13 DG

Dëshmitari ishte intervistuar nga policia më 15 korrik 2011. Ai ka deklaruar se vëllai i tij BU kishte shkuar për Sllovakia rreth dy vite më parë. Ai kishte pirë një kafe me vëllain e tij dhe një N nga X disa ditë para nisjes së tij. Ai e kuptoi se ky person ishte lidhja që e ndihmoi vëllain e tij për të shkuar jashtë vendit. Më vonë ai e kontaktoi këtë N sepse ai i njihte pesë persona të tjerë të interesuar për të shkuar jashtë shtetit. N nuk dëshiroi të diskutoj mbi këtë çështje përmes telefonit.

Dëshmitari në polici dha si numër të tij të telefonit 04XX.

Dëshmitari dëshmoi në gjykatë më 9 korrik 2012. Sipas dëshmitarit vëllai i tij BU kishte gjetur një lidhje për të shkuar jashtë vendit nëpërmjet disa miqve. Ai u takua me një person me emrin N, por ai nuk e di nëse ky është lidhja. Ai bisedoi me N në lidhje me shitjen e lopës. Atij nuk i kujtohet të ketë folur me N në lidhje me njerëzit të cilët duan të shkojnë jashtë vendit. Dëshmitari nuk e mban mend se ai ka deklaruar në polici se ai e kishte kontaktuar N në lidhje me njerëzit që janë të interesuar për të shkuar jashtë shtetit.

Më 26 mars 2011 një bisedë u përgjua ndërmjet dëshmitarit dhe NI, në të cilin i pari thotë se ata kanë nevojë të takohen urgjentisht ai i kishte pesë gjëra.

Gjykata konkludon se kjo është biseda të cilës dëshmitari është referuar në deklaratën e tij në polici. Gjykata konstaton se kjo deklaratë është e besueshëm, pavarësisht nga fakti se dëshmitari nuk e ka konfirmuar deklaratën e tij të mëparshme. Dëshmitari nuk ka dhënë ndonjë arsye se pse deklarata e tij e dhënë nga ana e policisë nuk është shkruar korrekt.

1.1.14 BV

Më datë 12 korrik 2011 dëshmitari dha deklaratë në polici dhe më datë 9 korrik 2012 dëshmoi në gjykatë.

Gjykata nuk do të marrë parasysh deklaratën e tij sepse nuk përmban informata specifike lidhur me ndonjërin nga të pandehurit.

1.1.15 BM dhe DRG

Këta dëshmitarë u dëgjuan më datë 10 korrik 2012. Të dy kanë dëshmuar mbi mënyrën si dëshmitarët janë dëgjuar. Disa dëshmitarë janë dëgjuar në një vend tjetër dhe jo në stacionin e policisë për shkak të rrethanave të veçanta. Sipas dy të dëshmitarëve marrja në pyetje e dëshmitarëve është bërë sipas standardeve të aplikueshëm.

1.1.16 AH

Ky dëshmitar ka dhënë deklaratë në polici, e cila është lexuar më datë 10 korrik 2012.

Gjykata nuk do të marrë parasysh këtë deklaratë sepse dëshmitari nuk ka dijeni të drejtpërdrejtë mbi përfshirjen e SB në kontrabandimin e migrantëve.

1.1.17 KM

Të gjitha palët u pajtuan që deklarata e KM të lexohej më datë 9 korrik 2012. Kur është marrë në pyetje nga prokurori publik më datë 16 shtator 2011 dëshmitari deklaroi se HB kishte shkuar një ditë në dyqanin e tij. Ai i kishte thënë HB se ai kishte një nip i cili donte të shkonte jashtë. HB i kishte dhënë atij numrin e telefonit të një personi i cili merrej me këto çështje.

Dëshmitari deklaroi në polici numrin e tij të telefonit 04XX.

Deklarata e këtij dëshmitari mbështetet edhe nga rezultatet e regjistrimit të telefonatave. Gjykata gjen deklaratën të besueshme.

1.1.18 RK

Më datë 920 korrik 2012 të gjitha palët u pajtuan që deklarata e RK dhënë para prokurorit më datë 16 shtator 2011 të konsiderohet si e lexuar. Ai deklaroi se ai njeh NI. Ai kishte dëgjuar se NI nxirrte njerëz jashtë vendit dhe kontaktoi atë për këtë arsye. N i dha atij numrin e një personi mashkull serb i cili mund të nxirrte dëshmitarin jashtë vendit. Ai foli me këtë person mbi çmimin, por ishte shumë i lartë. Dëshmitari pranoi një telefonatë më datë 15 janar 2011 kur ai kishte diskutuar çmimin me NI. N ishte ndërmjetës.

Deklarata e këtij dëshmitari mbështetet nga përgjimi i telefonatave. Për këtë arsye gjykata konstaton këtë dëshmitar të besueshëm.

1.1.19 MN

Deklarata e MN dhënë në polici më datë 13 tetor 2011 është konsideruar si e lexuar nga të gjitha palët më datë 11 korrik 2012. Ai deklaroi se ai punon si shofer autobusi për Bici.com në trajektoren Gjakovë - Vienë. Ai njeh NI nga X i cili merret me kontrabandimin e migrantëve. Sipas dëshmitarit, NI merret me këto aktivitete për 4 deri 5 vjet.

Gjykata nuk merr parasysh deklaratën e këtij dëshmitari sepse nga kjo deklaratë nuk është e qartë se si ai ka kuptuar se NI merret me kontrabandimin e dëshmitarëve.

1.1.20 AR

Deklarata e AR dhënë në polici më datë 29 shtator 2011 është konsideruar e lexuar me pajtimin e gjithë palëve më datë 9 korrik 2012. Ai deklaroi se punon si shofer taksie në rrugën Uglar-Gjilan. Ai deklaroi se ishte kontaktuar nga një person me emrin BE nga Bujanoci, me numër telefoni 04XX, lidhur me transportimin e personave në zonën kufitare me Serbinë. Ai kishte patur kontakte të rregullta me një person me emrin BS nga zona e X, voziste një Golf 2 të kuq dhe se ai gjatë gjithë kohës ishte me një uniformë sigurimi private. BS i kishte sjellë dëshmitarit afërsisht 17 herë persona për transport. Dëshmitari kishte kontakte gjithashtu me AM për të njëjtin qëllim. Ai i kishte dërguar atij rreth 3 herë persona për transport të mëtejshëm. Dëshmitarit iu treguan fotografi nga të cilat ai identifikoi 3, AB, NI dhe BI si persona që kishin dërguar persona në Gjilan për transport të mëtejshëm. Dëshmitari deklaroi në polici numrin e tij të telefonit 04XX.

Gjykata gjen këtë dëshmitar të besueshëm. Ai identifikoi personat që njeh me emra nga fotografitë që i ishin treguar. Ai është në dijeni mbi aktivitetet e personave që përmendi sepse ata i kishin sjellë atij persona për transportim të mëtejshëm.

1.2 Prova të tjera

1.2.1 Lidhur me NI

Përgjimi i telefonatave në numrin 04XX (NI)

Numri i NI 04XX është përgjuar nga data 26 tetor 2010 deri 30 prill 2011. Ai ka folur në këtë numër me migrantë të mundshëm. Në disa raste ai i adresoi ata tek një numër Ipko për të diskutuar hollësi të mëtejshme.

Më datë 4 nëntor 2010 N u pajtua që numri i tij t'i jepej dikujt i cili po kërkonte një person që t'a dërgonte atë jashtë vendit. Më datë 6 nëntor 2010 ai është pyetur se si mund të arrihej një marrëveshje

për dy persona për në Itali. Më datë 3 dhjetor 2010 dikush pyet N se sa duhen për në Francë, ndërsa N përgjigjet se ai nuk ka ndonjë lidhje atje. Më datë 14 dhjetor 2010 N pranoi një mesazh SMS ku thuhet: Hej N, jam A, ne jemi në Suboticë, do nisemi sonte dhe bëjmë marrëveshje me ta sepse nuk kam para. Më datë 15 dhjetor i njëjti person shkroi: Hej N, jam A, c'a ka të re, më trego me sms lidhur me nisjen tonë. Më datë 1 janar 2011 N thirret në telefon nga H i cili pyet se sa kushton për të dërguar dikë në Austri. Më datë 9 janar 2011 N udhëzon një person të jetë në Kieva në orën 3 sepse aty do të jetë një person që do t'a marrë. Më datë 13 janar 2011 N thirret nga dikush nga Austria i cili kishte disa problem me disa dokumente. Më datë 13 janar 2011 N merr në telefon H, i cili i kërkon që të kujdeset për atë kushëririn. Më datë 6 shkurt 2011 N pranon një telefonatë nga AG nga Zvicra, i cili e pyet nëse ai merret akoma me atë punë si më parë. Ai pyet për çmimin dhe kush do të jetë duke pritur në Vienë. N përgjigjet se ai akoma bën këtë punë, se çmimi është i njëjti dhe se ai ka një shok që po pret në Vienë. Më datë 21 mars N diskuton në telefon me HB se ka patur një defekt në udhëtim dhe se mbi 20 persona ishin kapur nga fqinjët dhe se nesër në mbrëmje ata duhet të organizojnë të dalin dhe të kalojnë kufinjët. Më datë 23 shkurt 2011 N flet me NA mbi një kushëri që nuk kishte mbërritur në destinacion. N i tregon NA të kontaktojë M nga Bujanovci sepse ai është personi kyç për këto çështje, ai menaxhon këto punë. Më datë 24 mars 2011 NA thërret N në telefon dhe i thotë atij të bisedojë me ta që të shohë nëse mund t'a vënë këtë djalin në autobus dhe nëse jo t'a kthejnë atë mbrapsht, sepse ata duan të më raportojnë në polici. Më datë 24 mars 2011 N i thotë NA të mos shqetësohet sepse ai (person i tretë) do të dërgohet në fund të javës. Më datë 31 mars 2011 SK thërret në telefon N dhe i thotë atij se nëse NA nuk telefonon deri në orën 14.00 se çdo gjë është në rregull, ai (N) do të ketë një problem. Më datë 2 prill 2011 N flet me RE i cili i thotë se ai po përgatit viza turistësh. Më datë 5 prill 2011 BS i jep N numrin e tij lpko. N i thotë BS të jetë në autobus dhe ai do t'i thotë atij se ku të shkojë në Mitrovicë. Më datë 9 prill 2011 N i thotë VE atje ata nuk janë në pozitë për të kaluar matanë sepse ka lindur një problem dhe gjërat nuk janë në rregull atë javë. Më datë 19 prill 2011 NA i thotë MU se ai i ka spjeguar atij (personi të tretë) gjithçka se do të jetë një udhëtim prej 12 ditësh. MU i thotë atij t'a dërgojë atë më parë sepse ai pritet në një vend pune atje.

Prova të marra nga Prokuroria e Përgjithshme e Republikës së Shqipërisë

Përgjimi i numrit të telefonit XX (AT/Shqipëri)

AT kontakton me N në numrin e tij të telefonit 00XX më datë 2 tetor 2010 në orën 8.06 në mëngjes. N i thotë AT se atyre u ishte bërë pritë në Hungari. Ai thotë se njëri nga të tutë po pret makinën tjetër, tjetri ishte kapur. Në orën 15:35 N i thotë AT se një makinë nuk mund të shkojë t'i marrë ata sepse ka shumë policë rrugës. N thotë ata janë tashmë në Hungari. Gjatë një bisede të mëparshme AT pyet emrin e personit që është kapur. Në orën 19:29 N i thotë AT se ata do t' i kthejnë ata në Serbi dhe se ata do të jenë në banesë për 30-40 minuta.

Më datë 3 tetor 2010 bëhet një kontakt tjetër. N i thotë AT se djali është mirë në Suboticë, ata nuk kishin arritur t'a çojnë në Austri dhe e kanë kthyer në Suboticë. Më datë 4 tetor 2011 N i kërkon AT një nder, të dërgojë € 300 në Suboticë për bukë për ata. Më datë 6 tetor 2010 N i thotë AT se ata po largohen dhe do të jenë atje mes 2 dhe 3. Djali kosovar që është me ta ka numrin. Më datë 21 tetor 2010 N thërret AT në telefon, i cili pyet atë se kur do të nisë K dhe shokun e tij AT. Më datë 25 tetor 2010 N i thotë AT ai (person i tretë) dërgoi personin tuaj dhe personin tonë në Itali. Një tjetër shkoi mirë në Suboticë.

Përgjimi i telefonit XX (

N thirret në telefon nga pronari i numrit shqiptar të telefonit XX më datë 15 tetor 2011, i cili e quan atë N. Ai e pyet atë mbi tre nipat. N thotë se njëri prej tyre ka shkuar me autobus në Vienë dhe se dy të tjerët do të shkojnë të shtunën në darkë.

Përgjimi i telefonit XX (PG /Shqipëri)

Më datë 5 shtator 2010 PG thërret N në numrin e tij të telefoni 00XX. N i thotë atij se ata u nisën sepse atje kishte shumë kontroll. Më vonë atë ditë N pyet PG për numrin e atij që po pret dhe flet italisht. Ai sqaron në një bisedë të mëvonshme se atij i duhet numri i përcjellësit, i cili me sa duket është një kilometër para të tjerëve. Më datë 16 shtator PG i dërgon N një tekst SMS që ata do të nisen nesër. Më datë 19 shtator ata diskutojnë lidhur me persona që janë liruar dhe nuk janë shoqëruar nga policia. Më vonë atë ditë PG i thotë N që ai do t'i kthejë ata. Ai i thotë N t'i thotë T që t'i marrë ata, sepse ai tha që ai do t'a bënte. PG i thotë N që të jetë i kujdesshëm. PG i dërgon mesazh SMS N ku i kërkon që të flasë me atë gruan dhe të nxjerrin L, që ai t'i tregojë familjes së tij që është shëndoshë e mirë.

Përveç këtyre kontakteve mund të gjenden edhe shumë të tjerë me përmbajtje që lidhet me dërgimin e personave nga një vend në një tjetër.

Rezultatet e regjistrimit të numrit të telefonit 04XX (NI)

Mes fundit të dhjetorit 2010 dhe majit 2011 janë regjistruar kontakte mes këtij numri telefoni dhe numrave të NA, BI dhe HB.

Rezultatet e regjistrimit të numrit të telefonit 04XX

Mes dhjetorit 2010 dhe majit 2011 janë regjistruar 42 kontakte mes këtij numri telefoni dhe numrit të telefonit të TB (04XX). Gjithashtu edhe kontakte të rregullta mes numrit 04XX dhe numrave jashtë, janë regjistruar edhe telefonata hyrëse dhe dalëse. Janë regjistruar kontakte të rregullta mes 04XX dhe numrit 04XX.

Raporti mbi zbulimin e të dhënave financiare të datës 8 gusht 2011

Më datë 4 dhjetor 2010 NI pranoi € 1000 nga BK në Belgikë. Më datë 12 dhjetor 2011 ai i dërgon € 500 RA në Suboticë, Serbi.

BI pranoi në llogarinë bankare të Pro Creditit një pagë prej € 896 dhe ai depozitoi € 1400 në këtë llogari bankare në periudhën kohore nga 2 shtator 2010 dhe 12 maj 2011. Ai ka dërguar € 400 dhe € 800 personave në Austri në mars 2011. Ai ka dërguar € 2400 më datë 15 mars 2011 një personi në Serbi.

1.2.2. Lidhur me NA

Telefonatat e përgjuara në numrin 04XX (NI)

Më datë 23 shkurt 2011 N flet me NA lidhur me një të afërm që nuk kishte mbërritur në destinacion. N i tregon NA të kontaktojë M nga Bujanovci sepse ai është personi kyç për këto çështje, ai menaxhon këto punë. Më datë 24 mars 2011 NA thërret në telefon N dhe i thotë atij flasë me ta që të shohë nëse ata mund t'a vënë këtë djalë në një autobus dhe nëse jo t'a kthejnë mbrapsht, sepse ata duan të më raportojnë në polici. Të njëjtën datë NA flet me N lidhur me një person i cili është në Gjilan pa asnjë cent. Më datë 31 mars 2011 SK thërret N dhe i thotë atij që nëse NA nuk thërret në telefon deri në orën 14.00 që çdo gjë është në rregull, ai (N) do të ketë një problem. Më datë 31 mars 2011 SK merr në telefon N dhe i thotë se nëse NA nuk thërret në telefon deri në orën 14.00 që çdo gjë është në rregull, ai (N) do të ketë një problem.

Është domethënëse biseda e 24 marsit 2011 në orën 10.30.55, gjatë së cilës NA informon NI se një djalë duhet të vihet në autobus sepse “ata duan të shkojnë të më raportojnë në polici”. Sipas të pandehurit kjo është lidhur me një djalë të cilit ai I dha numrin e telefonit të N.

Rezultatet e regjistrimit të numrit të telefonit 04XX (NA)

Mes tetorit 2010 dhe prillit 2011 ka kontakt të rregullt mes NA dhe numrave të Valës të NI.

1.2.3 Lidhur me BI

Telefonatat e përgjuara në numrin 04XX (NI)

Më datë 6 prill 2011 N thirret në telefon nga VB i cili e pyet atë për numrin e BS. VB pyet N sa kushton transporti deri atje. N përgjigjet se ai e paguan atë 50, por se është më e thjeshtë për të marrë një taksë.

Rezultatet e regjistrimit të numrit të telefonit 04XX

Mes nëntorit 2010 dhe prillit 2011 janë pranuar dhe bërë më shumë se 30 (tentativa) telefonatash mes numrit të BI dhe numrave të NI: 04XX dhe 04XX. Gjithashtu janë regjistruar kontakte mes numrit të BI dhe numrit 04XX, i cili ishte në përdorim nga NI.

1.2.4 Lidhur me aktivitetet e HB

Përgjimi i telefonatave të numrit të telefonit 04XX (NI)

Më datë 13 prill 2011 HB merr në telefon NI dhe I thotë atij se ka një shok I cili njeh shumë njerëz të interesuar për të shkuar jashtë vendit. Emri i tij është KM.

Përgjimi i telefonatave në numrin 04XX (HB)

Më datë 7 maj 2011 BAM thërret HB dhe e pyet nëse ai mund të bëjë një vizë shengen për një kushëri të afërt. HB përgjigjet duke thënë se nuk mundet për shkak se ata po vonohen. Më datë 14 maj 2011 L thërret HB lidhur me një familje e cila do të shkojë në France ose në Suedi. Sipas HB ata mund t'i çojnë vetëm deri në Vienë, por se nga Viena nuk ka problem. Të njëjtën datë HB I thotë II I cili e merr atë në telefon sepse ai t'a çojë djalin e tij jashtë vendit, ata mund t'a çojnë atë në Vienë.

Rezultatet e regjistrimit të numrit të telefonit 04XX (HB)

Mes këtij numri dhe numrit të KM (04XX) janë regjistruar 19 thirrje (tentativa) në prill dhe maj 2012. Mes këtij numri dhe numrit të telefonit të NI janë regjistruar kontakte mes tetorit 2010 dhe fillimit të majit 2011.

1.2.5 Aktivitetet e AB

Përgjimi i telefonatave në numrin 04XX (AB)

Më datë 11 shkurt 2011 AB thirret nga një person i panjohur I cili pyet për çmimin për të shkuar në Austri. AB thotë se është € 2000, por se për hokë mund të jetë €1800. Diskutohet edhe mënyra e udhëtimit. AB thotë se ata duhet të ecin pak. Të njëjtën datë AB diskuton një çështje tjetër financiare. Ai nuk mund të vendosë por duhet të pyesë dikë tjetër. Më datë 12 shkurt 2011 AB flet me një shok në telefon dhe i thotë atij se po bart viza me një shok, ata japin viza për të shkuar në perëndim, duke shtuar se ai po rri në Kosovë si budalla. Më datë 8 mars 2011 AB thirret në telefon nga një person i panjohur i cili e pyet atë se kur do të shkojnë, nëse duhet të presin gjatë, nëse ka nevojë të flenë dhe nëse ai ka një banesë. Më datë 25 mars 2011 AB thirret nga një person i panjohur I cili e pyet për çmimin për të dërguar një person në Austri dhe ai përgjigjet 1.8.

Më datë 1 prill 2011 AB diskuton në telefon vendndodhjen e një personi të kontrabanduar. Gjatë kësaj bisede AB thotë se S është anëtar i të njëjtit rrjet kontrabandues siç është ai vetë.

1.2.6 Aktivitetet e TB

Provat e pranuar nga Prokuroria e Përgjithshme e Republikës së Shqipërisë

Përgjimi i numrit të telefonit XX (AT /Shqipëri)

Më datë 28 gusht 2010 AT dërgon mesazh sms TB (që përdor numrin e telefonit 04XX) dhe e pyet atë nëse ai do që punëtori të jetë nesër në anën e tij sepse ata kanë përsëri një dërgesë. T përgjigjet se ai ka dy apo tre punëtorë rreth të mërkurës apo të enjtes.

Përgjimi i numrit të telefonit XX (PG /Shqipëri)

Më datë 5 shtator 2010 PG i dërgon TB numrin e telefonit të AT përmes një mesazhi sms. Të njëjtën ditë TB dërgon një AT duke e pyetur atë se si është, nëse ai është mirë. Më datë 16 shtator 2010 PG i dërgon një sms TB ku i thotë se ai ka një ose dy për ditët e nesërme dhe se si do t'a bëjnë. Më datë 2 nëntor 2010 PG ankohet se TB i ka dërguar disa tashmë por se ka lënë sërish të vetin (ose të vetët) me Turqit pa i dërguar.

Rezultatet e regjistrimit të numrit telefonik 04XX

Mes dhjetorit 2010 dhe majit 2011 142 janë regjistruar 142 kontakte mes këtij numri telefoni dhe numrit të telefonit të TB (04XX). Gjithashtu janë regjistruar kontakte telefonike të rregullta mes numrit 04XX dhe numra jashtë vendit, janë regjistruar kontakte hyrëse dhe dalëse.

Rezultatet e ekspertizës mjeko-ligjore

Në një kartelë të IPKO-s, konfiskuar gjatë bastisjes së shtëpisë së BI, numri i telefonit 04XX ishte ruajtur me emrin N. Numri 04XX ishte ruajtur me emrin M.

2. Lirim nga akuza

Të gjithë të pandehurit: krim i organizuar

Provat e paraqitura nuk të çojnë në përfundimin se të pandehurit kanë formuar një grup të organizuar me qëllimin e përfitimeve materiale nga kontrabandimi me migrantë.

NI ka qenë në kontakt me të gjithë të pandehurit e tjerë, përveç AM dhe SB. Nuk është përcaktuar asnjë kontakt mes të pandehurve. Nuk ka prova që tregojnë se ata ishin në dijeni se persona të tjerë ishin gjithashtu në lidhje me NI lidhur me kontrabandimin e migrantëve. Nuk ka prova se të pandehurit kanë qenë duke vepruar në mënyrë të organizuar. Përshtypja që krijohet nga dosja e lëndës është se personat që ishin në kontakt me NI e dinin se ai kishte kontakte mes të cilave ishte në gjendje të nxirrte persona jashtë vendit. Gjykata konstaton se ai ka përdorur numrin e lpkos për të organizuar udhëtimet e migrantëve dhe ka kontaktuar bashkëpunëtorët e tij në vende të tjera. Numrat e lpkos nuk kanë qenë të përgjuar, nuk është e qartë se si janë bërë organizimet saktësisht.

I pandehuri HBI: kontrabandimi i migrantëve

Telefoni I të pandehurit nuk është përgjuar. Sipas thirrjeve telefonike të përgjuara në telefonin e NI, ai ka folur me të disa herë të ndryshme mes datës 3 shkurt dhe 11 shkurt 2011. Ai ka kontaktuar gjithashtu NI më datë 20 mars 2011. Nuk është vërtetuar se ai ka qenë në kontakt me ndonjë prej të pandehurve të tjerë. Kontaktet mes NI dhe HB mund të kenë qenë lidhur me nisjen e FBI, vëllain e HBI.

Gjykata nuk gjen të besueshme deklaratën dhënë nga NI se HBI ka marrë € 50 nga shuma e udhëtimit paguar nga vëllai i tij. NI nuk ka dhënë asnjë arsye se pse HBI ka marrë këto të holla. Deklarata nuk mbështetet nga asnjë provë tjetër.

Nuk ka prova të mjaftueshme se HBI ka qenë i përfshirë në kontrabandimin e migrantëve, dhe se ai ka qenë pjesë e grupit të organizuar, përfshirë në këtë. Për këtë arsye i pandehuri është liruar.

I pandehuri SB: kontrabandimi i migrantëve

Në fjalën e tij përmbyllëse prokurori iu referua bisedave telefonike të marra nga përgjimi i telefonatave të të pandehurit më datë 27 janar 2011. Këto përgjime nuk janë përfshirë në dosjen e lëndës dhe për këtë arsye nuk mund të përdoren si prova. Edhe sikur këto të ishin përfshirë në dosjen e lëndës këto biseda janë prova të papranueshme sepse këto burojnë nga përgjime të bëra në bazë të një urdhri të përkohshëm të prokurorit i cili nuk ishte konfirmuar nga gjykatësi i procedurës paraprake brenda 24 orësh nga lëshimi i tij në pajtim me Nenin 258, paragrafi 4 KPPK.

Numri i telefonit të të pandehurit 04XX është përgjuar nga data 3 shkurt deri 4 mars 2012. Gjatë kësaj periudhe nuk janë bërë nga ai biseda fajësuese.

Gjykata nuk ishte në gjendje të gjente raportin 15 ditor të datës 27.01.2011 ose 27.10.2010, përmendur nga prokuroria i cili vërteton se SB ka përdorur numrin e telefonit 04XX. AB ka deklaruar para kësaj gjykate se ky është numri i tij dhe se ai nuk ia ka dhënë këtë kurrë në përdorim SB dhe nuk ka fakte që kundërshtojnë këtë deklaratë. Për këtë arsye gjykata arrin në përfundimin se numri i telefonit nuk është përdorur nga SB.

Deklarata dhënë nga IB nuk mbështetet nga prova të tjera. Nuk mund të arrihet në përfundimin se S përmendur nga ai është SB.

Nuk ka prova të cilat tregojnë se i pandehuri ka qenë në kontakt me ndonjë nga të pandehurit e tjerë.

Gjykata nuk gjeti asnjë provë se i pandehuri ka qenë i përfshirë në kontrabandimin me migrantë dhe se ai ka qenë pjesë e ndonjë grupi të organizuar përfshirë në këtë. Për këtë arsye i pandehuri lirohet nga akuza.

I pandehuri HT

Nga regjistrimi i thirrjeve telefonike del se ka patur kontakte mes numrit të telefonit të HT dhe numrave të telefonëve [përdorur nga NI më datë 1, 9, 13, 14, 15, 16 dhe 17 janar 2011. Transkriptet e dy prej këtyre kontakteve mund të gjenden në dosjen e lëndës. Më datë 1 janar 2011 në orën 12:17:34 HT thërret NI dhe e pyet atë se sa kushton që të dërgojë një person në Austri. Kjo pyetje nuk ka gjasa të shtrohet nga dikush qw ështëw (përfshirë në një organizatë që merret me) kontrabandimin e migrantëve. Më datë 13 janar 2011 HT i thotë NI "kujdesu për këtë kushëririn". Këto biseda implikojnë se një kushëri i HT po dilte jashtë vendit përmes NI, kjo nuk vërteton se HT ka marrë ndonjë përfitim nga ky udhëtim. Kontaktet e tjera mes NI dhe HT me sa duket nuk kishin të bënin me kontrabandimin e migrantëve, sepse asnjë nga këto kontakte nuk janë përfshirë në dosjen e lëndës.

Jashtë kësaj periudhe nuk ka patur kontakte mes numrave të telefonit të NI dhe HT.

Përkundër asaj që deklaroi prokurori në fjalën e tij përmbyllëse, nuk është gjetur asnjë provë që i pandehuri ka patur kontakte të vazhdueshme me të akuzuarit dhe të dyshuarit e tjerë.

Gjykata nuk gjeti asnjë provë që i pandehuri ishte I përfshirë në kontrabandimin e migrantëve si dhe se ai ka qenë pjesë e ndonjë grupi të organizuar të përfshirë në këtë. Për këtë arsye i pandehuri lirohet nga akuza.

Të gjithë të pandehurit: rrethana rënduese

Nga këto deklarata dhënë nga dëshmitarët nuk mund të arrihet në përfundimin se migrantët janë kontrabanduar duke rrezikuar jetën e tyre apo duke vënë në rrezik integritetin e tyre fizik. Fakti se kufijtë duhet të kaloheshin në këmbë gjatë natës nuk është I mjaftueshëm për të përcaktuar këtë rrezik. Kjo rrethanë rënduese nuk është vërtetuar.

NI: posedim i paautorizuar i drogës

Gjatë bastisjes së një makine të vjetër në oborrin e shtëpisë së tij u gjet një sasi prej 2.02 gramë kanabis. I pandehuri mohoi se e ka ditur që në këtë makinë pa pasur drogë. Sasia e gjetur e drogës nuk tregon se i pandehuri ka qenë i përfshirë në shitjen e drogës. Meqënëse nuk ka tregues të tjerë se një gjë e tillë qëndron nuk mund të arrihet në përfundimin se ai kishte drogën me qëllim për t'a shitur.

HB: posedim i paautorizuar i armës

Gjatë bastisjes së shtëpisë të të pandehurit më datë 18 maj 2011 u gjet një pushkë gjuetie, për të cilën i pandehuri nuk mund të paraqiste një leje për armë mbajtje. Gjatë shqyrtimit kryesor i pandehuri paraqiti një letër nga Ministria e Punëve të Brendshme e cila përmban një vendim të përgjithshëm me anë të të cilit është zgjatur vlefshmëria e lejeve për armë mbajtje për shkak të hyrjes në fuqi të një ligji të ri mbi armët. Përmes kësaj letre leja për armëmbajtje e armës të të pandehurit është zgjatur dhe ka qenë e vlefshme gjatë bastisjes së shtëpisë. Për këtë arsye i pandehuri ka qenë në posedim të një leje për armë gjatë periudhës së përmendur në aktakuzë. Fakti që i pandehuri nuk e ka paraqitur këtë dokument më herët nuk ndryshon përfundimin e arritur nga trupi gjykues.

3. Gjetjet Faktitke

3.1 Përdorimi i numrave të Ipkos

Më datë 27 janar 2011 NI dërgon një sms BS në numrin 04XX duke i thënë atij që të hapë Ipkon e tij sepse nuk punon. Më datë 2 shkurt N pranon një telefonatë nga F i cili e pyet nëse ka ndonjë ndryshim për Itali. N thotë se do t'a marrë përsëri në telefon nga një numër tjetër. Më datë 6 shkurt 2011 në orën 13:55:09 N pranon një telefonatë nga NM i cili ka në përdorim numrin e telefonit 04XX. N thotë se do t'a marrë atë përsëri në telefon nga një numër tjetër. Më datë 6 shkurt 2011 në orën 13:58:49 është regjistruar një telefonatë nga numri 04XX në numrin 04XX.

HB merr në telefon NI më datë 22 shkurt 2011 dhe i thotë se ai ka 3 ose 4 gati për nesër. N i thotë atij që t'a marrë në telefon në ipko.

Më datë 25 mars N thirret në telefon nga një person të cilin nuk e njeh i cili thotë se ai e ka marrë numrin nga një shok për një punë. N thotë se do të telefonojë atë sërish nga numri i tij Ipko.

Më datë 5 prill 2011 BS thërret N dhe i thotë se numri i tij ipko nuk punon. N thotë se ai ka një tjetër të cilin do t'ia japë BS më vonë. Regjistrimi I thirrjeve telefonike tregon se përdorimi i numrit të ipkos 04XX pas kësaj date ka qenë minimal. Më date 5 prill 2011 BS i jep N numrin e tij Ipko. N i thotë BS që të jetë në autobus dhe se ai to t'i tregojë se ku të shkojë në Mitrovicë. Më datë 13 prill 2011 HB pyet N nëse ai mund t'ia japë numrin e tij Ipko dikujt i cili njeh shumë persona të cilët duan të shkojnë jashtë vendit por se ipko nuk punon. N i thotë se ai ka një numër tjetër ipko.

Gjykata konkludon se numrat ipko janë rezervuar për biseda të caktuara. Duke parë natyrën e këtyre bisedave gjatë të cilave i është referuar numrave ipko, këto numra janë përdorur për biseda mbi kontrabandimin e migrantëve dhe përgatitjeve për këtë aktivitet. Përmbajtja e këtyre bisedave nuk dihet sepse këto numra telefoni nuk janë përgjuar megjithëse numrat kanë qenë të njohur për policinë.

3.2 NI

Kontrabandimi i migrantëve

I pandehuri nuk ka dhënë spjegim të besueshëm për telefonatat e përgjuara të përmendura më lart. Duke marrë parasysh provat e tjera, në veçanti, deklaratat e dëshmitarëve, gjykata arrin në përfundimin se këto biseda telefonike janë mbi kontrabandimin e migrantëve.

Në bazë të provave gjykata arrin në përfundimin se NI ka qenë përfshirë në këto aktivitete nga një datë e panjohur në 2009 deri më datë 18 maj 2011. Dëshmitari DG, kur është marrë në pyetje, deklaroi se vëllai i tij ka shkuar jashtë shtetit përmes NI dy vjet para vitit 2011.

Sipas deklaratave të XT, AP, TA, EA, AD, NS, SB, DG dhe RK, i pandehuri ka diskutuar çmimet për të kontrabanduar jashtë vendit. Këto kanë qenë mes € 1400 deri € 2000. Në deklaratat e tyre disa prej dëshmitarëve kanë përmendur rrugën e udhëtimit, nga Kosova përmes Serbisë në Hungari dhe nga aty në destinacionet e tyre në shtete të Evropës, Francë, Itali dhe Austri. Të gjithë personat e përfshirë në këto biseda ishin shtetas të Kosovës. Mes personave të kontrabanduar ishin XT, OP, EA, BS. Përveç këtyre personave janë kontrabanduar edhe persona të tjerë të cilët nuk kanë arritur të identifikohen. Qëllimi i përfitimit material nga hyrja e paligjshme në një shtet të tretë rrjedh nga çmimet që janë kërkuar nga migrantët potencialë.

Dyshohet se i pandehuri ka përdorur numrin e tij ipko për të qenë në kontakt me bashkëpunëtorët e tij në vende të tjera sepse me këtë numër ai ka pasur shumë kontakte me numra telefoni jashtë Kosovës. Përgjimet e marra nga policia e Shqipërisë të cilat tregojnë se përmes numrit të tij ipko ai ka patur kontakte të rregullta me PG, AT dhe VH lidhur me persona të cilët donin të largoheshin nga Shqipëria përmes Kosovës.

NI ka organizuar udhëtimet për migrantë (potencialë) dhe ka vendosur mbi çmimet dhe oraret. Ai ka udhëzuar migrantët mbi udhëtimin dhe ka qenë në kontakt me personat të cilët kanë shoqëruar migrantët gjatë udhëtimit. Nga mënyra e udhëtimit, ndryshime të shumta të makinave, pjesërisht në këmbë, duhet të arrihet në përfundimin se në vendet e treta si Serbia dhe Hungaria personat janë future pa përmbushur kushtet e nevojshme për hyrje të ligjshme në këto shtete.

Posedim i paligjshëm i armës

Gjatë bastisjes së shtëpisë së tij janë gjetur dy armë, një Cervena Zastava numër serik C-132079 dhe një revolver me gaz Ekol Tuna numër serik ET 892018 dhe 4 fishekë për këtë armë. I pandehuri ka deklaruar se ai ka poseduar këtë armë që nga lufta dhe se nuk ka patur leje për këtë armë. Prodhimi dhe funksionimi i armëve është përcaktuar përmes raportit të ekspertizës.

3.3 TB

Në bazë të provave të vlerësuara më lart, gjykata arrin në përfundimin se TB ka qenë përfshirë në kontrabandimin e migrantëve nga një datë e panjohur në 2010 deri më datë 18 maj 2011. Ai ishte në kontakt me PG, AT dhe VH. Policia shqiptare hetoi këta tre të dyshuar. Gjatë këtij hetimi u përgjuan telefonët e tyre. Disa transkripte të bisedave janë cituar më lart.

Kur i pandehuri është intervistuar nga prokurori ai ka pranuar përfshirjen e tij në aktivitetet e NI. Spjegimi i tij se ai vetëm ka kontaktuar personat e lartpërmendur vetëm në emër të NI nuk është i besueshëm sepse janë vërtetuar kontakte nga një numër Ipko i cili është gjetur në telefonin e njërit prej dëshmitarëve me emrin e të pandehurit dhe NI ka përdorur numrin e tij të Ipkos për të kontaktuar këta persona në Shqipëri. Kur është marrë në pyetje nga prokurori i pandehuri ka pranuar se ka përdorur numrin 04XX. Mohimi i kësaj deklarate nga ana e tij gjatë shqyrtimit kryesor nuk është i besueshëm.

Rezultatet e regjistrimeve tregojnë shumë kontakte mes numrave të Ipkos dhe të pandehurit dhe NI, dhe numri ipko në përdorim nga i pandehuri dhe numri përdorur nga M, i cili sipas përgjimit të një telefonate nga NI është gjithashtu përfshirë në kontrabandimin e migrantëve.

I pandehuri gjithashtu ka mbajtur në ruajtje paratë derisa emigranti të arrinte destinacionin e tij. Deklarata bërë në këtë drejtim nga i pandehuri mbështetet nga deklarata e TA. Gjykata nuk gjen të besueshëm mohimin e deklaratave të mëparshme të të pandehurit dhe të dëshmitarit. Ata nuk kanë mundur të sigurojnë një arsye të pranueshme se pse kanë nënshkruar deklaratat e tyre me shkrim të cilat nuk përputheshin me deklaratat me gojë që kishin bërë.

I pandehuri bëri përgatitjet e udhëtimit me bashkëpunëtorë jashtë vendit dhe ka luajtur një rol vital financiar duke ruajtur paratë për migrantët. Nuk mund të vërtetohet se i pandehuri është përfshirë në kontrabandimin e migrantëve përmendur në aktakuzë. Qëllimi i përfitimit financiar nga hyrja ilegale në një shtet të tretë buron nga çmimet të cilat janë kërkuar nga migrantë (potencialë) apo se ka diskutuar me ta.

3.4 NA

Megjithëse janë konstatuar kontakte të rregullta mes NA dhe NI gjatë periudhës tetor 2010 dhe maj 2011, i pandehuri ka mohuar se njih NI gjatë intervistës së parë me prokurorin. Pasi është ballafaquar me transkriptin e një përgjimi, ai deklaroi se ai ia ka dhënë numrin e N dikujt i cili donte që kontrabandohej.

I pandehuri nuk ka dhënë spjegim të besueshëm mbi mohimin e parë që ka bërë se ka njohur NI. Gjatë vlerësimit të provave gjykata ka konsideruar këtë në disfavor të të dyshuarit. Nuk ka patur nevojë që i pandehuri të mohojë se ka njohur NI, nëse kontaktet me të kanë qenë lidhur me aktivitete të ligjshme.

Fakti se NI i ka dhënë të pandehurit numrin ipko të një personi me emrin M, i cili sipas NI i di “këto gjëra”, tregon përfshirjen e të pandehurit në kontrabandimin e migrantëve. Megjithëse edhe njerëz të tjerë kanë kërkuar vendndodhjen e të afërmeve të kontrabanduar, NI nuk ia ka dhënë asnjërit prej tyre numrin e të tjerëve për të pyetur lidhur me këtë. Numri i telefonit të M është gjetur gjithashtu edhe në një sim kartelë, e cila u gjet në shtëpinë e BI.

Roli i të pandehurit ka qenë që (në mënyrë aktive) të referonte persona tek NI, i cili kishte kontakte për të dërguar njerëz jashtë. Ai ishte mjaft mirë në dijeni mbi natyrën e paligjshme të këtyre aktiviteteve sepse kishte frikë se mund të lajmërohej në polici.

3.5 HB

Ka shume kontakte (tentativa) mes NI dhe HB. Në disa prej këtyre kontakteve është referuar që të kontaktohej mes numrave të ipkos. Meqënëse gjykata ka konkluduar se numrat e ipkos janë përdorur për biseda mbi aktivitete kontrabandimi gjykata arrin në përfundimin se HB ka qenë gjithashtu i

përfshirë në këto aktivitete. Kjo është vërtetuar gjithashtu me anë të përgjimit të telefonatave të lartpërmendura.

Roli i të pandehurit ishte që (në mënyrë aktive) të referonte persona tek NI I cili kishte kontakte që të dërgonte persona jashtë. Ai është më pak i përfshirë sesa NI dhe TB.

3.6 AB

Dëshmitari BH ka deklaruar se ai ka kontaktuar të pandehurin për të shkuar jashtë vendit. Ata nuk kanë arritur ndonjë marrëveshje për shkak të çmimit. Më vonë dëshmitari ka referuar persona tek i pandehuri i cili ka rregulluar nisjen e tyre. Dëshmitari RB ka marrë në telefon në numrin e të pandehurit pasi djali i tij ishte larguar nga vendi. Dëshmitari AR ka identifikuar të pandehurin si njërin prej personave i cili i dërgonte atij persona për transportim të mëtejshëm. Gjatë një bisede telefonike të përgjuar i pandehuri i thotë një shoku se ai po përgatit viza. Ai informon gjithashtu persona të interesuar për të shkuar jashtë vendit lidhur me çmimet dhe mënyrat e udhëtimit. Kjo vërteton se ai e dinte se çfarë përfshinin aktivitetet e kontrabandimit.

Nga provat mund të arrihet në përfundimin se i pandehuri ishte i përfshirë në kontrabandimin e emigrantëve. Nuk ka prova se ai ka bashkëpunuar me NI ose ndonjë prej të pandehurve të tjerë. Roli I tij nuk ka qenë në nivelin më të lartë.

3.7 BI

Dëshmitari AR ka identifikuar të pandehurin si një person i cili i kishte sjellë atij persona për të transportuar në Sllubice. Mes të pandehurit dhe NI janë regjistruar kontakte telefonike. Gjykata arrin në përfundimin se këto kontakte përfshinin kontakte lidhur me migrantë, sepse edhe i pandehuri ka kontaktuar numrin e telefonit ipko të NI. Rezultatet e zbulimit të të dhënave financiare tregojnë se i pandehuri ka marrë dhe dërguar të holla nga jashtë. Spjegimi se llogaria e tij bankare është përdorur nga një person i tretë nuk është i besueshëm, i pandehuri nuk ka siguruar material mbështetës për këtë spjegim. Këto transfertat duhet të kenë qenë mbi kontrabandimin e migrantëve.

Gjykata arrin në përfundimin se i pandehuri ka qenë i përfshirë në kontrabandimin e migrantëve. Ai ka vepruar më tepër në mënyrë mbështetëse duke ndërmarrë detyra të vogla por të rëndësishme.

4. Dënimet

Janë marrë parasysh si në vijim.

Kontrabandimi i migrantëve është shkelje e të drejtës së çdo shteti në kontrollin e hyrjes nga persona që nuk janë banorë të atij shteti. Migrimi i paligjshëm mund të shkaktojë problem shoqërorë në shtetet pranuese. Për këtë arsye kontrabandimi i migrantëve duhet të ndiqet penalisht dhe kryerësit duhet të dënohen.

Të pandehurit nuk kanë qenë më parë të dënuar.

Gjykata konsideron të pandehurit NI dhe TB si ata me rolet kryesorë. Ata kanë qenë në kontakt me persona jashtë shtetit për një periudhë të gjatë kohore, NI nga 2009 dhe TB të paktën nga fillimi i vitit 2010.

Të pandehurit e tjerë kanë qenë më pak prominentë dhe kanë qenë më shumë mbështetës aktivitetëve të organizatorëve të vërtetë. Ata kanë dhënë informata migrantëve potencialë dhe kanë çuar migrantët në vende dhe prej aty ata janë dërguar më tej.

Rrethanat lehtësuese janë gjetur në faktin se disa dëshmitarë kanë deklaruar se një pjesë e pagesës duhet të bëhej pasi emigranti kishte arritur shëndoshë e mirë në destinacion. Nuk ka prova se të pandehurit kanë qenë duke kërkuar në mënyrë aktive migrantë duke promovuar aktivitetet e tyre.

Posedimi i paligjshëm i armëve përbën kërcënim për sigurinë shoqërore. Për këtë arsye armët e paligjshme konfiskohen.

Në pajtim me Nenin 73 (1) KPK koha e kaluar në paraburgim /arrest shtëpiak llogaritet në dënim.

Dënimet e shqiptuara kundër të pandehurve janë të duhura dhe të nevojshme.

5. Shpenzimet e procedurës

Në nenin 102 paragrafi 1, KPPK, thuhet se gjykata vendos që personi i cili është shpallur fajtor është ai që paguan shpenzimet e procedurës penale. Në pajtim me këtë Nen personat e dënuar paguajnë shpenzimet e procedurës. Dispozitat e Nenit 100 paragrafi 2, KPPK, do të zbatohen me anë të një aktvendimi të veçantë mbi shumën shpenzimeve.

Shpenzimet e të pandehurve SB, HT dhe HBI paguhen nga buxheti i Kosovës, meqenëse ata janë liruar nga të gjitha akuzat.

Procesmbajtës:

Christine Sengl

Kryetare e Trupit Gjykses:

Cornelie Peeck

Anëtar i Trupit Gjykses:

Naim Kurteshi

Anëtar i Trupit Gjykses:

Rasim Behluli

GJYKATA E QARKUT Prizren
P. Nr. 288/11
Aktgjykimi NI ea.

Mjet ligjor:

Palët kanë të drejtë të ushtrojnë ankesë kundër aktgjykimit brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga momenti kur është dorëzuar një kopje e aktgjykimit, në Gjykatën Supreme përmes Gjykatës së Qarkut Prizren në pajtim me Nenin 398 paragrafi 1, KPPK.

Shtojca 1

- P1.** Raport Përmbledhës mbi lëndën PG numri referues 2010-DIOK-69 i datës 17 maj 2011, CD bashkëngjitur CD
- P2.** Raporti i policisë mbi përgjimin e telekomunikimeve lidhur me numrin 04XX i datës 10/11/2010
- P3.** Raporti i policisë mbi përgjimin e telekomunikimeve lidhur me numrin 04XX i datës 26/11/2010
- P4.** Raporti i policisë mbi përgjimin e telekomunikimeve lidhur me numrin 04XX i datës 8 dhjetor 2010
- P5.** Raporti i policisë mbi përgjimin e telekomunikimeve lidhur me numrin 04XX i datës 20 dhjetor 2010
- P6.** Raporti i policisë mbi përgjimin e telekomunikimeve lidhur me numrin 04XX i datës 17 janar 2011
- P7.** Raporti i policisë mbi përgjimin e telekomunikimeve lidhur me numrin 04XX i datës 1 shkurt 2011
- P8.** Raporti i policisë mbi përgjimin e telekomunikimeve lidhur me numrin 04XX i datës 15 shkurt 2011
- P9.** Raporti i policisë mbi përgjimin e telekomunikimeve lidhur me numrin 04XX i datës 1 mars 2011
- P10.** Raporti i policisë mbi përgjimin e telekomunikimeve lidhur me numrin 04XX i datës 4 prill 2011
- P11.** Raporti i policisë mbi përgjimin e telekomunikimeve lidhur me numrin 04XX i datës 20 prill 2011
- P12.** Raporti i policisë mbi përgjimin e telekomunikimeve lidhur me numrin 04XX i datës 3 maj 2011
- P13.** Raporti i policisë mbi përgjimin e telekomunikimeve lidhur me numrin 04XX i datës 18 shkurt 2011
- P14.** Raporti i policisë mbi përgjimin e telekomunikimeve lidhur me numrin 04XX i datës 4 mars 2011
- P15.** Raporti i policisë mbi përgjimin e telekomunikimeve lidhur me numrin 04XX i datës 18 shkurt 2011
- P16.** Raporti i policisë mbi përgjimin e telekomunikimeve lidhur me numrin 04XX i datës 4 mars 2011
- P17.** Raporti i policisë mbi përgjimin e telekomunikimeve lidhur me numrin 04XX i datës 19 mars 2011
- P18.** Raporti i policisë mbi përgjimin e telekomunikimeve lidhur me numrin 04XX i datës 4 prill 2011
- P19.** Raporti i policisë mbi përgjimin e telekomunikimeve lidhur me numrin 04XX i datës 20 shkurt 2011
- P20.** Raporti i policisë mbi përgjimin e telekomunikimeve lidhur me numrin 04XX i datës 7 mars 2011
- P21.** Raporti i policisë mbi përgjimin e telekomunikimeve lidhur me numrin 04XX i datës 22 mars 2011
- P22.** Raporti i policisë mbi përgjimin e telekomunikimeve lidhur me numrin 04XX i datës 24 tetor 2011
- P23.** Raporti i policisë mbi përgjimin e telekomunikimeve lidhur me numrin 04XX i datës 18 tetor 2011
- P24.** Raport mbi telefonatat hyrëse dhe dalëse dhe mesazhet SMS NR.2010DKKO069 të Policisë së Kosovës, i datës 1 dhjetor 2010 lidhur me numrat e telefonëve 04XX dhe 04XX përfshirë CD bashkëngjitur këtij raporti
- P25.** Raport mbi telefonatat hyrëse dhe dalëse dhe mesazhet SMS NR.2010DKKO069 të policisë së Kosovës së datës 13 qershor 2011 lidhur me numrat e telefonëve 04XX, 04XX, 04XX dhe 04XX, 04XX, 04XX përfshirë CD bashkëngjitur këtij raporti.
- P26.** P25 Raport mbi telefonatat hyrëse dhe dalëse dhe mesazhet SMS NR.2010DKKO069 të policisë së Kosovës së datës 29 qershor 2011 lidhur me numrat e telefonit 04XX, 04XX, 04XX, 04XX, 04XX, 04XX dhe 04XX përfshirë CD bashkëngjitur raportit.
- P27.** Raport mbi telefonatat hyrëse dhe dalëse dhe mesazhet SMS NR.2010DKKO069 të policisë së Kosovës së datës 29.07.2011 lidhur me numrat e telefonit 04XX, 04XX, 04XX dhe 04XX përfshirë CD bashkëngjitur këtij raporti.
- P28.** Letër për ndihmë ligjore e Prokurorisë për Krime të Rënda të Republikës së Shqipërisë, nr. 380/2 i datës 23 maj 2011 përfshirë transkriptet e bashkëngjitura mbi përgjimin e telefonëve kësaj letre 04XX dhe 04XX bashkëngjitur kësaj letre.
- P29.** Raporti i hetimit financiar Nr.13-DHKO/SHFI-2011/20 të datës 8 gusht 2011.
- P30.** Raport mbi bastisjen dhe vërtetime mbi konfiskimin e përkohshëm të sendeve të datës 18 maj 2011.
- P31.** Dokumentacioni fotografik për të gjithë të pandehurit.
- P32.** Raporti i ekspertizës së Njësisë së Shkencave Ligjore, analiza kimike e datës 11 gusht 2011.